

## Vizitë e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Në datat 20 dhe 21 Prill 2017, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i kryesuar nga Z. Shkëmb Manaj, zhvilloi një vizitë studimore në Tiranë me ftesë të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil të Shqipërisë, Znj. Pranvera Strakosha.



Programi i vizitës dyditore përfshiu takime me Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil të Shqipërisë dhe disa drejtorë të këtij institucioni, takim me Kryetarin e Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë, Z. Kastriot Selita, me Drejtorin e Departamentit të Administratës Publike, Znj. Albana Kociu, si dhe me Ministrin e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Znj. Milena Harito.

Qëllimi i kësaj vizite ishte shkëmbimi i përvojave dhe praktikave më të mira në administrimin e shërbimit civil, si dhe diskutimi i sfidave dhe problematikave të hasura në këtë fushë. Pas fjalës përshëndetëse të mbajtur nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Znj. Pranvera Strakosha, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Z. Shkëmb Manaj bëri një prezantim të shkurtër të stafit të tij si dhe na njohu me procesin e ndryshimeve në shërbimin civil të Kosovës.

Më tej, drejtorët e institucionit të Komisionerit i njohën anëtarët e Këshillit me sistemin e shërbimit civil në Shqipëri, procesin e mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, zbatimin e vendimeve të Komisionerit si dhe sfidat e hasura gjatë këtyre dy viteve.

Gjatë takimit me Kryetarin e Gjykatës Administrative të Apelit, Z. Kastriot Selita, ky i fundit e informoi Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në lidhje me funksionet e gjykatës administrative të apelit si dhe u diskutua mbi mënyrën e trajtimit të mosmarrëveshjeve administrative për aspekte të veçanta të shërbimit civil.



Gjatë takimit me Drejtorin e Departamentit të Administratës Publike, Znj. Albana Koçiu, të dyja palët shprehën kënaqësinë e përbashkët për këtë vizitë, duke shprehur reciprokisht vullnetin për një bashkëpunim të mëtejshëm. Gjatë këtij takimi, u diskutua mbi aspekte të ndryshme të menaxhimit të shërbimit civil, që administrohen nga Departamenti i Administratës Publike. Fokus i veçantë ju kushtua procesit të rekrutimit dhe sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore.



Gjatë takimit me Ministrin e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Znj. Milena Harito, Këshilli u njoh me rolin e kësaj ministrie në shërbimin civil dhe administratën shtetërore, ndërlidhjen e ministrisë me fushën e shërbimit civil, rolin e ministres në procesin e rekrutimit të nëpunësve civilë dhe strukturimit të administratës publike, si dhe transferimet e nëpunësve civilë ndërmjet shteteve.

